

**VENDIM
Nr. 55/2014**

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, ORGANIKËS
DHE KATEGORIZIMIT TË POZICIONEVE TË
PUNËS TË INSPEKTORATIT TË LARTË TË
DEKLARIMIT E KONTROLLIT TË PASURIVE
DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të neneve 9, pika 2, e 10, pika 1, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, me propozimin e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit e Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I. Miratohet struktura, organika dhe kategorizimi i pozicioneve të punës së Inspektoratit të Lartë të Deklarimit e Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, sipas lidhjeve nr. 1 e 2 bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Vendimi nr. 40, datë 6.5.2013 i Kuvendit të Shqipërisë, shfuqizohet.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare më datë 1 shtator 2014.


**KRYETARI
Ilir Meta**

Miratuar në datën 31.7.2014

Lidhja nr. 1

STRUKTURA

INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE



Lidhja nr. 2**ORGANIKA DHE NUMRI I PUNONJËSVE TË INSPEKTORATIT TË LARTË TË DEKLARIMIT E KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE**

Funksioni	Nr. i punonjësve/Kategoria/klasa	
I. Inspektori i Përgjithshëm	1 Ligj nr. 9584, datë 17.7.2006	
II. Kabineti		
Drejtor Kabineti	1	II-a
Këshilltar	1	II-b
Sekretar i Inspektorit të Përgjithshëm	1	VKM
III. Sekretari i Përgjithshëm	1	I-b
IV. Inspektorë		
Inspektorë	12	II-a
Ndihmës Inspektorë	12	II-b
V. Drejtoria e Kontrollit Paraprak, Aritmetik-Logjik dhe e Konfliktit të Interesave		
Drejtor	1	II-b
Specialistë	4	III-b
VI. Drejtoria Juridike dhe e Marrëdhënieve me Institucionet		
Drejtor	1	II-b
VI/1. Sektori i Marrëdhënieve me Autoritetet Përgjegjëse		
Përgjegjës sektori	1	III-a
Specialistë	3	III-b
VI/2. Sektori i Këshillimit Juridik		
Specialistë	2	III-b
VII. Drejtoria e Financave dhe Administrimit		
Drejtor	1	II-b
VII/1. Sektori i Administrimit të IT		
Përgjegjës sektori	1	III-a
Specialistë	2	III-b
VII/2. Sektori i Protokoll-Arkivit dhe Administrimit të Deklaratave të Pasurisë		
Përgjegjës sektori	1	III-a
Specialistë	4	III-b
VII/3. Sektori i Administrimit të Financë-Buxhetit		
Specialist finance	1	IV-a
Specialist buxheti	1	III-b

Magaziner	1	VI
Shofer	1	IV
Receptionist	1	III
Pastruese	2	I
Gjithsej	57 punonjës	